



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 75, Datë 15.03.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PAJISJE ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË
ORIGJINËS TË IMPIANTIT FOTOVOLTAIK TË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NË DIGËN E QYRSAQIT, HEC “VAU I DEJËS”, TË SHOQËRISË
“KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16 të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 7 dhe 8 të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 229, datë 20.12.2019; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “d”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 991/1 prot., datë 13.03.2023, të Drejtorive Teknike të ERE-s “Mbi fillimin e procedurës për pajisje me certifikatë të Garancisë së Origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, hec “Vau i Dejës”, të shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” sh.a.”,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 991 prot., datë 03.03.2023, shoqëria “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” sh.a., ka paraqitur kërkesën për pajisjen me Certifikatën e Garancisë së Origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, Hec “Vau i Dejës”, të shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” sh.a., për periudhën 13.05.2022-31.12.2022.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 21.07.2022, është vendosur kualifikimi i këtij impianti fotovoltaik.
- Në zbatim të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” sh.a., rezulton i plotësuar Aneksi 1, gërmat “a” dhe “c”; neni 7, pika 7.4, gërmat “a” dhe “c” gërmat “a”, “b”,

“c”, “ç”, “d”, “e”, “ë” dhe “g”; neni 7, pika 7.5, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”.

Në kuadër të plotësimit të këtij aplikimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE:

- Në lidhje me sasinë reale të prodhuar nga ky impiant për vitin 2022 (nga data 13.05.2022 deri më 31.12.2022), ERE do t'i drejtohet OST sh.a. me një kërkesë për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga ky impiant gjatë kësaj periudhe.

Aneksi 1. Formati i Aplikimit

- **gërma “b”** Aktin përkatës të përfaqësimit/autorizimin e përfaqësuesit ligjor.

Neni 7, pika 7.4

gërma “f”: Shoqëria duhet të depozitojë çdo dokument tjetër të lëshuar që dëshmon kolaudimin dhe komisionimin e impiantit prodhues të energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për pajisjen me Certifikatë të Garancisë së Originës të impiantit fotovoltaiik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, Hec “Vau i Dejës”, të shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” sh.a., për periudhën 13.05.2022-31.12.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI